



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KABINETI

Bulevardi " Bejram Curri " Tiranë, Albania Tel/Faks +355 4 362 937 www.moh.gov.al

Nr. 4400 Pril

Tiranë, më 13/12 /2011

URDHËR

Nr. 511, Datë 13/12/2011

**"PËR KRITERET
E PUNËSIMIT NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR PUBLIK"**

Mbështetur në nenin 102.pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe VKM nr 176 datë 29/03/2006 "Për botimin e buletinit të njoftimeve publike" me qëllim për të rritur cilësinë e shërbimit në institucionet shëndetësore duke përzgjedhur specialistët më të kualifikuar të sektorit të shëndetësisë:

URDHËROJ:

1. Punësimi në institucionet shëndetësore të bëhet vetëm nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në kritere të përcaktuara.
2. Njoftimi për vendet e lira të punës të bëhet në Buletinin e Njoftimeve Publike .
3. Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna mbi vendin e punës , kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacionin që duhet paraqitur, vendin dhe kohën e dorëzimit të dokumenteve si dhe kërkesa të tjera të nevojshme.
4. Kërkesa të detyrueshme për të konkuruar për një vend të lirë pune janë diploma, certifikata e notave, certifikata e specialitetit (të noterizuara), leja e ushtrimit të profesionit nga urdhri i profesionistëve përkatës, referenca nga punëdhënësit e mëparshëm, ndërsa kriteret të vlerësimit me pikë të kandidatëve janë nota mesatare, provimet pas diplomimit, gjuhët e huaja, gradat apo titujt shkencor, kurse të ndryshme kualifikimi etj.
5. Konkurrimi për një vend pune është i hapur me përjashtim të kandidatëve që lëvizin nga një rreth në tjetrin të cilët duhet të kenë marrë miratimin nga drejtuesi i institucionit i si dhe miratimin e transferimit nga Ministri i Shëndetësisë.

6. Kandidati që konkurren për një vend të lirë pune, përveç vlerësimit që i bëhet dokumentacionit të tij, i nënshtrohet detyrimisht një interviste para një komisioni ad-hoc i përbërë jo më pak se tre persona, ngritur nga titullari i institucionit . Intervista vlerëson motivimin për punë, personalitetin, njohjen e gjuhëve të huaja, aftësinë komunikuese, etj.
7. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

▪ **Nota mesatare**

- Mbi 9 vlerësohet 15 pikë
- Mbi 8 " 12 pikë
- Mbi 7 " 8 pikë
- Mbi 6 " 4 pikë
- Mbi 5 " 2 pikë

- Grada apo titulli shkencor vlerësohet 20 pikë.
- Gjuha e huaj e vërtetuar vlerësohet 3 pikë
- Përvoja mbi 10 vjet vlerësohet 5 pikë.
- Intervista (maksimalisht) vlerësohet 10 pikë.

8. Pas përzgjedhjes së kandidatit, emërimi i konkurrentit bëhet nga drejtuesi i institucionit përkatës.
9. Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrat Shëndetësore do të zbatohet VKM Nr. 857, datë 20.12.2006 (i ndryshuar) "Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore", rregullorja e funksionimit të bordit të qendrave shendetesore në nivel DRSH/DSHP/ASHR dhe statuti i qendrës shëndetësore.
10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për procesin e përzgjedhjes, brenda 5 ditëve pranë Drejtorive përkatëse.
11. Në këtë urdhër nuk përfshihen kriteret e punësimit në spitalet universitare.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

